

Ali Pajaziti, PhD¹

UDC:
316.356.2-027.511"20"

**FAMILJA E SHEKULLIT XXI: KONTEKSTI GLOBAL,
BALLKANIK DHE SHQIPTAR**

**СЕМЕЈСТВОТО НА XXI ВЕК: ОД ГЛОБАЛЕН, БАЛКАНСКИ
И АЛБАНСКИ КОНТЕКСТ**

**THE FAMILY OF THE XXI CENTURY: GLOBAL, BALKAN AND
ALBANIAN CONTEXT**

“S’ka shtëpi pa pleq dhe pa fëmijë”.
(fjalë popullore)

Abstract

The word “family” is of latin origin, famulus, which means servant, slave, house slave. Family is a social group whose members are affiliated with origin, marriage, adoption, living together, cooperate economically, emotionally and spiritiually and care for each other. It is a social institution that constitutes the basic, functional and structural structure of any society. Cooley has called family the first and ideal example of primary groups, “nursery of the human character,” the creator of the most emotional feelings of the human being. With a lot of wisdom, someone has called it “the oldest social institution that never gets old”, as “the safest institution for man”. It is the only shelter where people find security, rest and love. People in the family have the opportunity to preserve their differences and freedom. Today, in the global framework, the family is referred to as an endangered entity, as institution in crisis, where domestic violence is increasing day by day. In connection with the subject many researches detect single-member households, child education crisis, atomization and defunctionalization of the family, cohabitations (conensual unions), ever-growing divorces and the like. This paper aims to give an overview of the tendencies in the broader and local context of

¹ Sociolog, profesor i rregullt, Universiteti i Evropës Juglindore, Shkup.

the problems faced by the family of XXI century as an institution sui generis without which society can not survive. As a method, content analysis, documentation, comparative, statistical data were used. The findings are that in the Balkans and in the Albanian context the family also experiences a serious turbulence that is evident in the social trends.

Key words: *family, modernity, emancipation, moral crisis, divorce, EUROSTAT, one-person households*

1. Familja: Vështrim i përgjithshëm

Institucioni i familjes është njësi sociale, ku gatuhet shpirti i pjesëtarëve të ardhshëm të shoqërisë, ku jepen dhe ndërtohen vlerat, është njësi ekonomike që njeriut ia plotëson nevojat materiale. Nga ana tjetër, meqë është fryt i ndërveprimit të biologjisë së njeriut me rrethin, është edhe institucion bio-social, por edhe institucion ideologjik, ngaqë është rezultat i pikëpamjeve si duhet të sillen me njëri-tjetrin femra me mashkullin. Edhe Balzaku dhe Comte mendojnë se familja është njësia kryesore e shoqërisë e jo individit, së këndejmi kërkohet që individit t'ia nënshtrojë dëshirat e veta institucionit të familjes. Në gjuhën japoneze fjala familje dhe qilim janë të njëjta (*kamai*), që është metaforë e ndërlidhjes së ngushtë mes nyjave të qilimit dhe familjeve që e përbëjnë shoqërinë. (Bullaç, 2005) Në mesjetë kanë ekzistuar familjet e zgjeruara, si edhe sot në vendet islame dhe në një pjesë të Lindjes. Në shekullin XVI dhe XVII, familja ka nënkuptuar familjen e zgjeruar, me prindërit, gjyshin e gjyshen dhe fëmijët. Me shfaqjen e Revolucionit Industrial, formohet e ashtuquajtura familje atomike, kurse sot, në qytetin virtual, formohen familje njëprindërshe, me një fjalë familja shkatërrohet. Gruaja dhe burri formojnë familje me fëmijët e vet, divorci shkon duke u bërë gjë e përditshme, që vazhdimisht mbështetet nga teleseksualiteti i përhapur nga produktet e Revolucionit të Katërt apo Digjital, nga teknologjitë informatike dhe rrjetet sociale.

2. Tipologji të familjes

Sociologët kanë bërë tipologji të ndryshme të familjeve duke filluar nga ajo apo patriarkale, konjugale, atomike, e zgjeruar, monogame, egalitare, e ndarë, njëgjakëshe, ndërmarrëse, burokratike e kështu me radhë. (Zanden, 1999: 667; Kullashi: 2003: 218) Familja patriarkale (*patriarchal family*), në të cilën pushtetin e ka në duart e veta mashkulli si *pater familias*; familje në të cilën fjalën kryesore e ka burri si nga ana e përgjegjësisë për mirëqenien ashtu edhe të „pushtetit“. Familja bërthamë (nukleare), që formohet vetëm prej nënës, babait dhe fëmijëve, që ndryshe mund të quhet

edhe familje bërthamore ose bashkëshortore e kufizuar (*restricted conjugal family*), familja e zgjeruar, që përbëhet nga familja bërthamë dhe farefisi i afërt si gjyshi, gjyshja, xhaxhallarët, halla, nipat dhe mbesat, që jetojnë nën një çati. (Pajaziti, 2009) Një lloj tjetër është edhe ajo e përzier (*blended family*), e përbërë nga çifti i martuar he trashëgimtarët nga martesat e mëparshme. Shkrimet e sociologjisë së familjes shënojnë edhe familjen jofunksionale, në të cilën kujdestarët e rritur nuk janë në gjendje ose nuk duan që t'i kryejnë përgjegjësitë e tyre familjare, familjen bërthamë diadëshe (*nuclear dyad family*), të përbërë nga bashkëshorti dhe bashkëshortja pa fëmijë, familjen egalitare (*egalitarian family*) apo barazimtare në të cilën autoriteti ose „pushteti“ ndahet në mënyrë të barabartë mes burrit dhe gruas, familjen anarkike (*anarchical family*), që karakterizohet nga çorganizimi, nga mungesa e rregullave, nga të mundësuarit anëtarëve, madje edhe fëmijëve, që të bëjnë çka duan, nga permisiviteti, familjen dyvendore (*bilocated family*), e ndarë në dy hapësira gjeografike, njëra pjesë në vendlindje, pjesa tjetër në emigracion e të tjera.

3. Sociologjia e familjes

Ekziston një disiplinë e veçantë sociologjike që si lëndë studimi e ka familjen, si bashkësi në të cilën përmbushet më së miri dhe sqarohet ekzistenca njerëzore dhe përbërja komplekse shoqërore-ekonomike, biosociale e shoqërore-kulturore e njeriut. Themelues i sociologjisë së familjes është Fredereick Le Play, i cili me veprën e tij *Punëtorët evropianë* (*Les ouvriers européens*, 1855) i vuri konturet e kësaj discipline që deri atëherë mësohej në kuadër të teorive josociologjike. Duke shfrytëzuar metodën empirike ai mblodhi të dhënat për buxhetin familjar dhe mënyrën e jetesës së punëtorëve evropianë. Thuajse në të njëjtën kohë edhe F. Engelsi ka tubuar të dhëna empirike lidhur me familjen që i botoi në veprën *Gjendja e klasës punëtore në Angli* (*The Condition of the Working Class in England*, 1844), por pikëpamja e tij dallon nga ajo e Le Play-it sepse nisat nga ideja për luftën e klasave. Sociologjia e familjes duke studiuar këtë institucion prej martesës e deri te plakja e çifteve ngërthen perspektivën e ciklit jetësor. Kjo disiplinë merret me sistemet familjare të së kaluarës si dhe me ato që po ndryshojnë në kohën tonë, me llojshmërinë e jetës familjare të klasave, grupeve etnike ose të rajoneve të ndryshme gjeografike, me ndërveprimin mes jetës familjare dhe punës (karrierës), me mënyrën se si makrodimensionit shoqëror dhe ekonomik ndikon në mikromarrëdhëniet familjare, me rolin e gjinisë brenda familjes bashkëkohore, me martesën dhe divorcin, dhunën brenda familjare, me

çështjen e ardhmërisë së familjes etj. Sipas Hillit dhe Housen-it, pesë korniza konceptuale që shfrytëzohen në studimin e familjes: ndërvepruese, strukturale-funksionaliste, ajo e gjendjes, institucionaliste dhe evolucioniste. Qasja ndërvepruese familjen e trajton si tërësi të individëve që janë në marrëdhënie të ndërsjella. Pikëpamja strukturale-funksionaliste e merr si një nga nënsistemet sociale, si një strukturë që ndërtohet nga rolet dhe statuset e caktuara. Qëndrimi situacionist nisët nga rrethi psikologjik i individit, ai institucional familjen e trajton si pjesë të shoqërisë së përgjithshme dhe thekson zhvillimin historik të saj, kurse pikëpamja evolucioniste bazohet në strukturën demografike dhe në diferencimin e roleve. (Jashari, 2006: 22-23; Aydın, 1997: 48)

4. Kriza në familjen e shekullit XXI: Konteksti global

Familja bashkëkohore apo ajo e epokës së globalizimit ka ndryshuar rrënjësisht. Rolet e anëtarëve dhe perceptimi për familjen kanë ndryshuar gjithashtu. Format stereotipike si “burri fitues i bukës” dhe “gruaja kujdestare e shtëpisë dhe e fëmijëve” gjithnjë e më tepër po rrallohen; shumica e shtëpive kërkojnë të ardhura nga të dy kokat e familjes me qëllim të “mbijetesës”. Teza për Tranzicionin e Dytë Demografik** parashikon një rezultat të njëjtë por thekson rolin e vlerave postmoderne që promovojnë individualizëm dhe vetërealizim. Për këtë individualizëm flet edhe Ulrich Beck që thotë se familja ka humbur fuqinë e vet ndërsa individi ka një autonomi të veçantë, është përgjegjës për dështimin apo suksesin e vet. Maksimizimi i individualizmit ka prurë degradime të shumta familjare, nga relativizimi i kurorës, të dhuna dhe problemet psikologjike. Sipas të dhënave të organizatave viktimologjike (organizata për ndihmë sakrificave të dhunës), gratë e niveleve dhe statuseve të ndryshme arsimore, profesionale dhe sociale janë objekt i dhunës mashkullore dhe të njëjtat nuk

** Tranzicioni i Parë (ose Klasik) Demografik (TPD) nënkupton rënien historike të mortalitetit dhe të fertilitetit që është shënuar nga shekulli XVIII dhe më pas në disa shtete evropiane dhe që vazhdon edhe sot e kësaj dite në shumicën e vendeve në zhvillim e sipër. Tranzicioni i Dytë Demografik si shprehje është krijuar nga Ron Lesthaeghe and Dirk van de Kaa në vitin 1986. TDD nënkupton një makro-vështrim të zhvillimeve shoqërore dhe ndryshimeve ideore që shkaktojnë sjellje demografike si jeta si njësh, bashkëjetesa para dhe pas martesore, shtyrja e lindjes së fëmijëve, epërsia e lartë e fertilitetit jashtëmartesor dhe shpërbërja e njësisë familjare. Nga ana tjetër, mikroniveli i kësaj pikëpamjeje thekson rëndësinë e vlerësimeve subjektive (në veçanti të vlerave) në qëndrimet lidhur me familjen dhe fertilitetin. Si karakteristika të tjera të TDD janë plakja e vazhdueshme e popullatës, integrimi i imigrantëve, përshtatja ndaj kulturave të tjera, dobësimi i stabilitetit të partneriteteve, dhe shkalla e lartë e varfërisë dhe përjashtimit në lloje të caktuara të familjeve. (EAPS, 2017; shih edhe Lesthaeghe, 2014)

kanë guxim dhe aftësi të shpëtojnë nga gjendja e tillë nënçmuese e robërimit “modern”. (Weiss El., 2000 në Šijaković, 2008).

Sipas Angie Blackwell (2017), e specializuar për dinamikat e familjes, për prindërimin dhe ndërmyjetësimin efektiv, sot, familja e zgjeruar është në listën e specieve në rrezik. Do të kishim shtuar, se në rrezik është madje edhe familja në përgjithësi. Ndër termat e përdorur është edhe shprehja “skenari për më pak familje” (“less family” scenario). Në veçanti në shoqëritë perëndimore janë bërë trend familjet njëanëtarëshe, të cilat nënkuptojnë një rregullim sipas të cilit individit siguron vetë ushqimin dhe gjërat e tjera të nevojshme për jetesë pa u bashkuar me ndonjë person tjetër, pa u bërë pjesë e një bashkësie dy e më tepër anëtarëshe. Familjet e shekullit XXI ndryshojnë jashtëzakonisht në formë dhe vëllim: divorci, rimartesa, prindërimi pa bashkëshort/e i kanë bërë demode madje edhe familjet bërthamë. Para një gjysmë shekulli, fëmijët janë rritur me dy prindërit biologjikë dhe me mbështetjen e anëtarëve të familjes së zgjeruar, kurse sot një pjesë e mirë e fëmijëve rriten pa njërin prind. Sot trende të përhapura gjithandej janë kohabitimi apo bashkëjetesa, kurse të dukshme janë edhe ekstremet si partnerët e seksit të njëjtë e të ngjashme.

“Family Crisis Center”, është një qendër asistuese nga Harlingeni i Texasit që merret me problemet e dhunës familjare, që ofron shërbime si këshillimi, intervenimi në rast krize, streha emergjente, avokatimi ligjor, shoqërimi spitalor etj. Të tilla ka edhe në vendbanime të shumta gjithandej SHBA-ve dhe më gjerë. Termat *helpline* dhe *crisis line* kanë funksionin e përafërt. Shumë tekste sociologjike flasin për rikomponimin e kurorës, partneritetit dhe familjes në shoqëritë bashkëkohore. (Bobić, 2003) Në Kanada në vitin 2003 është botuar libri i John F. Conway, *Canadian Family in Crisis* (Familja kanadeze në krizë), që flet për natyrën e ndryshuar të familjes, për viktimat e krizës (fëmijët, gratë, meshkujt), për mundësitë për lehtësimin e kësaj krize dhe për kahet e propozuara në politikat familjare. Nga 1966 deri më 2001 në Kanada divorcet janë rritur për 14 herë. Konservatorët bëjnë apologjinë e formave tradicionale të familjes, duke i atakuar format e reja dhe duke i cilësuar ato si promiskuitive dhe të panatyrshme.

Në një dokument të presidencës amerikane *The Family: Preserving America's Future* (Familja: Duke mbrojtur ardhmërinë e Amerikës) thuhet se kriza në familje është pasojë e eksperimenteve sociale liberale, pikëpamjes për divorc pa nevojën për arsyetim apo gjetje të ndonjë mangësie të palës tjetër (no-fault divorce), seksit permisiv dhe

mirëqenies së arritur lehtë. (Conway, 2003: xiii-xv). Sipas regjistrimit të vitit 2000, në SHBA ka pasur diku rreth 600 mijë çifte lesbianësh dhe homoseksualësh. Një trend i rritjes së madhe është shënuar edhe në numrin e personave që jetojnë të vetmuar: në vitin 1960, 13%, kurse në vitin 2000, 26% e popullatës. Në Meksikë çiftet rrinë në ujërat martesore mesatarisht dymbëdhjetë vjet. Një pjesë e mirë e çifteve ndahen në dy vitet e para të martesës, kurse qeveria ka vendosur të aplikojë lejet e përkohshme për ndarje, që t’iu mundësojë bashkëshortëve të mendojnë edhe një herë dhe të mund të ribashkohen. (Pixel, 2015) Pas gjetjes së tre foshnjave dhe pesë fëmijëve të vrarë në vendbanimet Paluen dhe Dar media gjermane hapën çështjen e krizës në familje dhe shtruan nevojën që me kushtetutë të parashihet marrja e fëmijëve – nga shteti - prej çifteve që nuk përkujdesen si duhet ose i keqtrajtojnë fëmijët e vet. (DW, 2007) Në vitin 2012, rreth 42 % të martesave në Angli dhe Uells kanë përfunduar me ndarje, kurse rreth 34 %, para 20-vjeçarit.

Ilustrimi 1: Shkalla e martesave për 1000 persona në periudhën 1960-2015.

	1960	1970	1980	1990	2000	2010	2011	2012	2013	2014	2015
EU-28 (*)	7.9	6.8	6.3	5.2	4.4	4.2	4.3	4.1	4.2	4.2	4.2
Belgium (*)	7.1	7.6	6.7	6.5	4.4	3.9	3.7	3.8	3.4	3.6	3.6
Bulgaria	8.8	8.6	7.9	6.9	4.3	3.3	2.9	2.9	3.0	3.4	3.9
Czech Republic	7.7	9.2	7.6	8.8	5.4	4.5	4.3	4.3	4.1	4.3	4.6
Denmark	7.8	7.4	5.2	6.1	7.2	5.6	4.9	5.1	4.9	5.0	5.1
Germany	9.5	7.4	6.3	6.5	5.1	4.7	4.6	4.8	4.6	4.8	4.9
Estonia	10.0	9.1	8.8	7.5	3.9	3.8	4.1	4.5	4.3	4.7	5.2
Ireland	5.5	7.0	6.4	5.1	5.0	4.5	4.3	4.5	4.5	4.8	4.8
Greece	7.0	7.7	6.5	5.8	4.5	5.1	5.0	4.5	4.7	4.9	5.0
Spain	7.8	7.3	5.9	5.7	5.4	3.6	3.4	3.5	3.3	3.4	3.6
France (*)	7.0	7.8	6.2	5.1	5.0	3.9	3.6	3.7	3.6	3.7	3.5
Croatia	8.9	8.5	7.2	5.8	4.9	5.0	4.7	4.8	4.5	4.8	4.7
Italy	7.7	7.3	5.7	5.6	5.0	3.7	3.4	3.5	3.2	3.1	3.2
Cyprus (*)	-	8.6	7.7	9.7	13.4	7.3	7.3	6.7	6.4	6.3	7.2
Latvia	11.0	10.2	9.8	8.9	3.9	4.4	5.2	5.5	5.7	6.3	6.9
Lithuania	10.1	9.5	9.2	9.8	4.8	6.0	6.3	6.9	6.9	7.6	7.6
Luxembourg (*)	7.1	6.4	5.9	6.1	4.9	3.5	3.3	3.4	3.2	3.0	3.1
Hungary (*)	8.9	9.3	7.5	6.4	4.7	3.6	3.6	3.6	3.7	3.9	4.7
Malta	6.0	7.9	8.8	7.1	6.7	6.3	6.2	6.7	6.1	6.7	7.0
Netherlands	7.7	9.5	6.4	6.5	5.5	4.5	4.3	4.2	3.8	3.9	3.8
Austria	8.3	7.1	6.2	5.9	4.9	4.5	4.3	4.6	4.3	4.4	5.2
Poland	8.2	8.6	8.6	6.7	5.5	6.0	5.4	5.4	4.7	5.0	5.0
Portugal	7.8	9.4	7.4	7.2	6.2	3.8	3.4	3.3	3.1	3.0	3.1
Romania	10.7	7.2	8.2	8.3	6.1	5.7	5.2	5.4	5.4	5.9	6.3
Slovenia	8.8	8.3	6.5	4.3	3.6	3.2	3.2	3.4	3.0	3.2	3.1
Slovakia	7.9	7.9	7.9	7.6	4.8	4.7	4.7	4.8	4.7	4.9	5.3
Finland	7.4	8.8	6.1	5.0	5.1	5.6	5.3	5.3	4.6	4.5	4.5
Sweden	6.7	5.4	4.5	4.7	4.5	5.3	5.0	5.3	5.4	5.5	5.3
United Kingdom	7.5	8.5	7.4	6.6	5.2	4.5	4.5	4.8	4.3	4.5	-
Iceland	7.5	7.8	5.7	4.5	6.3	4.9	4.6	-	-	-	-
Liechtenstein	5.7	5.9	7.1	5.6	7.2	5.0	4.5	5.0	-	-	-
Norway	6.6	7.6	5.4	5.2	5.0	4.8	4.6	4.8	4.7	4.6	4.5
Switzerland (*)	7.8	7.6	5.7	6.9	5.5	5.5	5.3	5.3	4.9	5.1	5.0
Montenegro	-	-	-	-	-	5.9	-	5.3	6.2	5.7	6.2
FYR of Macedonia	8.6	9.0	8.5	8.3	7.0	6.9	7.2	6.8	6.8	6.7	6.8
Albania	7.8	6.8	8.1	8.9	8.4	-	-	-	8.2	8.2	8.7
Serbia	-	-	-	-	5.7	-	-	-	-	-	-
Turkey	-	-	8.2	-	-	4.9	4.9	4.8	5.1	5.1	5.2
Bosnia and Herzegovina	10.1	9.3	8.5	6.7	5.6	5.1	-	4.8	-	-	-
Kosovo (*)	-	-	-	-	-	-	9.3	9.5	-	-	-

(*) Excluding French overseas departments for 1970 to 1990.

(*) 2011: break in series.

(*) Excluding French overseas departments for 1960 to 1990.

(*) Up to and including 2002: data refer to total marriages contracted in the country, including marriages between non-residents. From 2003 onwards: data refer to marriages in which at least one spouse was resident in the country. 1980: break in series.

(*) 2012: break in series.


(*) Under United Nations Security Council Resolution 1244/99.

Source: Eurostat (online data code: demo_nind)

Të dhënat e tabelës së mësipërme flasin se vetëm Malta në vitin 2015 ka shënuar rritje në numrin e martesave për 1000 veta krahasuar me vitin 1960. Të gjitha 28 shtetet anëtare të Unionit Evropian kanë shënuar rënie, disa edhe drastike, përgjysmim, si Italia, Belgjika, Bullgaria, Estonia, Gjermania etj. Sipas të gjetjeve të Eurostatit, shkallë më

të lartë të divorcit në kontekstin evropian për vitin 2015 kanë pasur Lituania (3.2), Gjermania (2.9), Letonia (2.6), dhe Çekia, Finlanda e Suedia (me nga 2.5). Bashkëjetesat janë më të përhapura në Suedi, Estoni dhe Francë, kurse më pak të përhapura në Greqi, Poloni dhe Maltë. (Eurostat, 2011) Në vitin 2015, në disa shtete anëtare të BE-së, lindjet jashtëmartesore kanë qenë më të shumta se sa lindjet brenda martesave: Francë (59.1%), Bullgari (58.6%), Estoni dhe Slloveni (57.9%), Suedi (54.7%), Danimarkë (53.8%) dhe Portugali (50.7%), Norvegji (55.9%). Vendet mesdhetare si Greqia, Qiproja, Kroacia dhe Malta, së bashku me Poloninë dhe Lituaninë, kanë qenë në anën tjetër të shkallës, pasi më shumë se 70% e lindjeve në secilin nga këto shtete anëtare janë brendamartesorë; në Turqi kjo përqindje ishte shumë e lartë 97.2%.

Ilustrimi 2. Kurba e martesave dhe divorceve në vendet evropiane për periudhën 1970-2013



Note: change in time interval on the x-axis. Excluding French overseas departments for 1970 to 1990.
Source: Eurostat (online data codes: demo_niind and demo_ndivind)

Kjo krizë e ka kapluar edhe botën lindore dhe hemisferën e jugut. Në Katar, 38 % e martesave nuk zgjasin as dhjetë vjet. Sipas një raporti të vitit 2011, 60% të çifteve përfundojnë në pesë vitet e para, kurse shumë prej tyre as që e shijojnë martesën. Mesatarja e kohëzgjatjes së martesave në Afrikën e Jugut është 11 vjet.

Sipas të dhënave të OKB-së në vitet 1950 shkalla e fertilitetit në Japoni ka qenë 2.75 fëmijë të shëndoshë për grua, në vitet 1960, 2.08,

kurse sot shkalla lindjeve për grua është 1.41. Fondi Monetar Ndërkombëtar para do kohe ua tërhoqi vërejtjen vendeve aziatike që t'i ruhen trajektoret japoneze të “plakjes para se të bëhen të pasur”, ndërsa *Business Insider* botoi një artikull me titullin në vijim: “Kjo është vdekja e familjes: kriza japoneze e fertilitetit krijoi mjerim të paparë ekonomik dhe social”. (Weller, 2017)

Të dhënat statistikore flasin se për shkak të rënies së natalitetit në botë po vdesin 79 kombe, prej të cilave 35 janë evropiane. Sipas raportit të organizatës “Human life” për vitin 2011, vetëm dy shtete evropiane kanë qenë mbi nivelin e riprodhimit, Malta dhe Shqipëria. (Katavić, 2014)

5. Kriza në familjen e shekullit XXI: Konteksti ballkanik dhe ai shqiptar

Kriza e familjes është prezente edhe në Ballkan, ndonëse njihet si një hapësirë më tradicionale ose më pak e modernizuar, krahasuar me Evropën Perëndimore. Ndryshimet rrënjësore të sistemit, gjegjësisht rrënimi i socializmit ka prodhuar ndryshime edhe në sferën e strukturës familjare. Sipas Hoffmann–Nowotny dhe Fux (2001: 40, në Bobić, 2003: 86) ndryshimet ekonomike nëpër të cilat kanë kaluar shtetet e Evropës Lindore dhe Ballkanit në dekadën e fundit të shek. XX kanë gjeneruar rënie të fertilitetit, përjashtimin masovik të grave nga tregu i punës, varfërim të përgjithshëm, shkatërrim të sistemit të sigurimit dhe për pasojë, në këto vende pritet vazhdim i rënies së numrit të popullatës që do të mbetet pa fëmijë, gjegjësisht forcim i polarizimit mes sektorit jo-familjar dhe atij familjar.

Rast studimor: Kriza në familjen kroate

Tek ne mbizotëron epidemia e prindërve indiferentë dhe tolerantë. Shtrohet pyetja se çka në fakt sot është familja kroate? Fëmijëve ua kanë dhënë rrugën dhe kompjuterin dhe mendojnë se e kanë kryer detyrën e vet. Familjet janë të frustruara, të pakënaqura, pjesërisht për shkak të krizës së përgjithshme që mbizotëron në shoqëri, pjesërisht për shkak të trashëgimit të pasojave. Ata nuk shohin mundësi të përparimit dhe ndryshimit. Kryesisht shkruhet për dhunë fizike, por kujdes të veçantë duhet kushtuar shpërfilljes, keqtrajtimit psikik të fëmijëve. Këto viktima vuajnë, janë të padukshme dhe të mbyllura në katër mure para monitoreve. Pas disa viteve do të kemi klinika për shmangie nga varësia prej internetit - tërheq vërejtjen sociologu dhe pedagogu, Zlatko Milisha nga Universiteti i Osijekut. Që është më interesante kriza në familjen kroate më e thellë është në zonat rurale se sa në ato urbane. (Vesić, 2013)

Radio Televizioni Serb në edicionin e lajmeve ka shfaqur titullin “Çfarë po ndodh me familjen”, duke u marrë me pyetjet si u arrit te gjendja që prindërit të mos kenë kohë për fëmijët e tyre, pse nuk mund të ballafaqohen me sfidat që fëmijët i kanë me internetin, me shkollën, me mësimdhënësit, dhe pse nga pafuqia e vet frustracionet i reflektojnë te fëmijët e tyre. (RTS, 2014) Në Mal të Zi, gjërat që para disa dekadave kanë qenë raritet sot janë bërë “të natyrshme”, gjithnjë e më tepër ka kërkesë për divorce, shiten pronat, rritet numri i prindërve që jetojnë vetëm e që flirtojnë me qëllim të gjetjes së lumturisë, është i madh numri i partnerëve që i drejtohen psikoterapeutit për këshillë si të shpëtojnë nga kriza bashkëshortore dhe familjare. (Rosandić, 2017) Kriza e familjes, që ndërlihet me krizën morale, vërehet edhe në Bosnjë e Hercegovinë: sipas një hulumtimi të vitit 2008, 60 % të të rinjve kanë shijuar marrëdhëniet intime. N. Dorontiq nga Qendra për punë sociale e Banja Llukës thotë se atje çdo e treta martesë përfundon me divorc. (Kontakt, 2013) “Gjithnjë e më tepër të rinjtë boshnjakë e shtyjnë për më vonë martesën, pranojnë martesë pa fëmijë dhe forma të padëshirueshme të sjelljes si prostitucioni, narkomania dhe alkoolizmi... Në krizë është roli reprodutiv i familjes.” (Ribić, 2015) Radio Evropa e Lirë citon sociologun S. Vukadinović, sipas të cilit, emancipimi i grave ka ndikuar që shumë femra të martohen pa qenë zyrtarisht në kurorë, gjë e paimagjinueshme para katër a pesë dekadash, kështu që kur në lidhjet e tilla joformale duan të lindin fëmijë, lindin vetëm një të tillë. Sipas parashikimeve demografike, deri në vitin 2050 popullata e Bosnjë-Hercegovinës do të pakësohet për 20%, ndërsa ekspertët arsyet i shohin te kriza ekonomike, pasiguria sociale dhe migrimit në rritje. (Katavić, 2014)

Një televizionin publik të Maqedonisë *MRTI*, nga viti 2012 emetohet një emision me titullin “Koha është për bebe (foshnje)”, që ndjek familjet të cilat presin fëmijë, ngjarjet para dhe rreth lindjes së fëmijës së dytë, të tretë. Emisioni në sfond shoqërohet me një këngë, ku mes tjerash thuhet, “të jemi më tepër, për këtë jap gjithçka”, “që në vendin tonë fëmijë të mençur të ecin”, “çdo të tretin qoftë edhe lejleku ta sjellë”, “mendo për ne, mendo për nesër”, “ra edhe ai çast, për një mëngjes të ri”...

“Koha për bebe” emetohet në kanal publik, në gjuhën maqedonase, që tregon se bëhet fjalë për një strategji shtetërore më të thellë, e cila ka për qëllim nxitjen e martesave tek të rinjtë maqedonas (etnikë), nxitjen e lindshmërisë, rritjen e shkallës së fertilitetit. Dhe analizat e

intelektualëve dhe instituteve maqedonase gjithnjë bëhen duke marrë parasysh ndryshorin shqiptar të këtij vendi. Siç dihet, një nga problemet kyçe të shoqërisë bashkëkohore është tkurrja demografike, rënia e lindshmërisë dhe reduktimi i numrit të anëtarëve të familjes, qelizën bazë të çdo rendi-organizmi shoqëror.

Familja etnike maqedonase dita-ditës po shformohet, të shpeshta janë familjet njëanëtarëshe dhe rastet e “beqarëve të përhershëm”. Migrimi fshat-qytet ka shkretuar 70% të fshatrave të Maqedonisë; rreth 500 syresh janë në rrugë të vdekjes, kryesisht në Maqedoninë lindore, të populluar me maqedonas etnikë. Nuk janë të rralla rastet si ai i Vojnishincit, me 90 shtëpi dhe 70 beqarë në moshë. (Pajaziti, 2016)

Sipas të dhënave të Entit Statistikor, në Republikën e Maqedonisë numri i divorceve në vitin 2014 është rritur për 8.1 % krahasuar me 2013 (*Republika*, 2015). Në periudhën 2006 deri më 2016 shënohet zvogëlim i martesave për 11.5 % dhe rritje e divorceve për 34.6%. (Makstat, 2016). Siç tregon edhe ilustrimi i mëposhtëm, evidente është edhe dukuria e vonimit apo shtyrjes së moshës së martesës për periudhën dhjetëvjeçare 2006-2016 të të dyja seksit, nga 27.6 vjet më 2006 në 29.3 m 2016 vjet te meshkujt, dhe nga 24.5 në 26.5 vjet te femrat.

	2006	2011	2016
Të lindur të gjallë	22 585	22 770	23 002
meshkuj	11 629	11 752	11 868
femra	10 956	11 018	11 134
Të vdekur	18 630	19 465	20 421
meshkuj	10 000	10 204	10 746
femra	8 630	9 261	9 675
Martesa	14 908	14 736	13 199
Divorce	1 475	1 753	1 985

Mosha mesatare e lidhjes së kurorës së parë:

dhëndri	27.6	28.3	29.3
nusja	24.5	25.4	26.5

Në 1000 banorë

të lindur gjallë	11.1	11.1	11.1
të vdekur	9.1	9.5	9.9
martesa	7.3	7.2	6.4
divorce	0.7	0.9	1.0

Ilustrimi 3. Statistikë vitale e RM-së (Përshatur sipas: Makstat, 2017: 13)

Ndikim negativ tek familja kanë edhe serialet e ndryshme që kanë krijuar një klientelë gjithëballkanike dhe përtej, që gjejnë “kurbanë” te grupet e ndryshme moshore që lidhen pas tyre në mënyrë marramendëse, që bëhen ndjekës të pasionuar dhe shpeshherë skemat e serialeve mundohen t’i jetësojnë në përditshmërinë e tyre, gjë që shkakton tërmete familjare, zënka, tradhti, divorce etj.


Çështje aktuale: Serialet televizive si virus social

“Këto seriale afirmojnë një mënyrë sekscentriste të jetesës, një botëkuptim të cekët, një shturje morale që kap në grepin e vetë turma të mëdha njerëzish jo vetëm tek ne por edhe në shumë vende të botës. Marrëdhëniet që mbizotërojnë në këto seriale shkaktojnë ngjalljen e një imagjinate sifilmike që i shtyn njerëzit të konstruktojnë jetën e tyre si tek x apo y filmi, shkaktojnë ‘legjitimimin’ e tradhtive, dashuriçkave etj.”

“Tragedia më e madhe qëndron aty se këto seriale i shikojnë të gjitha grupet moshore, madje edhe fëmijët, të cilët si një qenie e dëlirë përfshihen në harkun e ndikimit të këtyre filmave degradues dhe deeticizues. Humbja e kohës duke ndjekur kreativitetin denigrues të regjisorëve ngatërrestarë fatësh shpie në falimentim zhvillimor fëmijëror dhe ngathtësi intelektuale të më të rriturit.” (Pajaziti, 2016b)

Kriza familjare dhe “krisja tipologjike” e familjes është prezente edhe në Shqipëri dhe ndër shqiptarë në përgjithësi. Dikur familja shqiptare tradicionale ka qenë e zgjeruar, me shumë anëtarë që jetonin nën një kulm dhe kishin zotin dhe zonjën e shtëpisë, si qëllim jete ka pasur shtimin e anëtarëve të shtëpisë dhe të familjes nëpërmjet martesës, lindjes së fëmijëve, zhvillimin trupor dhe mendor të anëtarëve, kurse sot, ajo po katandiset. (Gjergji, 2016) Sipas një analisti, “familja shqiptare nuk është më”. Numri personave në familje ka zbritur nën katër, kurse divorcet shënojnë rritje dyshifrore për vit. Familja shqiptare po tkurret dhe po shpërbëhet, është në depresion. “Krimi në familje është kthyer në një fenomen të frikshëm dhe kjo ndikon negativisht jo vetëm në integritetin fizik, psikologjik, ekonomik dhe social të pjesës më të ndjeshme të shoqërisë (grave, fëmijëve, të moshuarve), por edhe në stabilitetin e familjes tradicionale”. Sipas tij, defunksionalizimi i familjes ka sjellë defunksionalizimin e elementëve më të qenësishëm të jetës sociale të njeriut. (Bakui, 20016) Në kontekstin shqiptar shënohet edhe dukuria e dominimit mashkullor ndaj femrës. Këtë e ilustron edhe rrëfimi i Dorinës, 22 vjeçe, e divorcuar, nënë me një fëmijë: “Shumica e burrave shqiptarë nuk e vlerësojnë gruan. Ata i konsiderojnë gratë si

skllave që duhet të kujdesen për fëmijët, për shtëpinë, të bëjnë të gjitha punët dhe kaq.” (Baben, 25) Ndërkohë ndaj femrës ushtrohet dhunë fizike, dhunë seksuale, ajo shndërrohet në objekt trafikimi. Rritja e prostitucionit dhe trafikimit të vajzave dhe grave ka bërë që në shumë zona rurale rreth 90% të adoleshenteve të braktisin arsimin e mesëm nga frika e rrëmbimeve (Save the Children Report, 2001). Sot nuk janë të rralla rastet kur femra nga Shqipëria “tregtohen” si nuse në Serbi, Bosnjë (në pjesën serbe) e Maqedoni (Blic, 2011, *Вечер*, 2014, *Telegraf*, 2017).



Ilustrimi 4. Fertiliteti në Kosovë brenda gjashtë dekadave (1950-2010). (Burimi: Dushi, 2011)

Dhuna në familje, mbetet një fenomen shqetësues në Kosovë. Vetëm në vitin 2016 janë shënuar 1225 raste të dhunës. Kjo është shifra e rasteve të raportuara në Policinë e Kosovës, kurse të shumta janë edhe rastet e dhunës brendafamiljare që mbahen fshehtë - shkruan Indeksonline. Prej këtyre statistikave të Policisë, janë evidentuar 987 viktima femra dhe 259 meshkuj. Një konstatim empirik është se në rajonet ku fryma islame është më e gjallë, edhe devijimet sociale, dhuna familjare, divorcet janë më të pakta, kurse përkujdesja për të moshuarit është ‘ligj’. Kjo në veçanti vlen për shqiptarët e Maqedonisë, që njihen si pjesa më konservatore e shqiptarisë, ku martesat ende janë trend (Топузовска Латковиќ, М. et. al., 2013: 19), kurse shtëpitë e pleqve për shqiptarë nuk ekzistojnë. “Në Maqedoni funksionojnë gjithsej 25 shtëpi të pleqve, nga të cilat njëzet në Shkup, dy në Manastir dhe nga një në Negotinë, Kumanovë dhe Prilep”, ku thuajse nuk ka shqiptarë. (Portalb, 2017)

6. Konkluzione

Të gjitha të dhënat dhe gjetjet kuantitative flasin për faktin se familja globalisht është në krizë, gjë që reflektohet edhe në kontekstin tonë të Maqedonisë dhe në atë shqiptar. Familja e periudhës së globalizimit shkon kah shpërbërja, në to nuk ka vend për tre breza. Procesi i shekullarizimit apo i dobësimit të ndikimit të fesë ka ndikuar në dobësimin e lidhjeve familjare. Mungesa e pleqve dhe tkurrja e familjes sjellin problemet që kanë të bëjnë me socializimin. Siç është shprehur një shkrimtar, kriza e “gjeneratës së Coca Cola-s dhe kompjuterëve” është edhe për shkak të mungesës së përrallave që mësoheshin në prehrin e më të vjetërve. Sot ka tendenca që disa funksione të familjes t’i kryejnë institucionet e reja: kopshti i fëmijëve, shkolla, konvikti, shtëpia e pleqve, shtëpitë e strehimit, deri te “monstra sociale e morale” i quajtur “Big Brother”! Prej tipit tradicional të familjes, që ishte një ambient i ngrohtë njerëzor, social, etik, moral dhe edukativ, familja ka marrë pamje të një anarkie sociale, është shndërruar në arenë konfliktesh, me tendenca individualiste e pavarësi ekonomike të pjesëtarëve të saj si te bashkëshortët ashtu edhe te pjesëtarët e tjerë të familjes. (Fetahu, 2012) Nga analiza e bërë arrijmë te konkluzionet dhe rekomandimet specifike në vijim:

- Problemet familjare janë të vjetra, shënohen në çdo periudhë të historisë njerëzore, por sot me përmasa më të mëdha.
- Sthurja thellësinore e familjes të kohës sonë, mes tjerash është pasojë e moderniz(i)mit dhe materializmit radikal.
- Modernizmi ka prurë jetesën e pavarur paramartesore, shtyrjen e martesës dhe bum në numrin e njerëzve në moshë.
- Mediatizimi i seksualitetit dhe serialet e ndryshme plot intriga, tradhti bashkëshortore e dëmtojnë rëndë familjen.
- Zbehja e ndjenjave fetare është në proporcion të zhdrejtë me shëndetin e familjes, sa më shumë që dobësohet fetaria aq më tepër cenohet familja.
- Familja shqiptare ende ka potencial për mbijetesë të shëndoshë, duke e pasur parasysh frymën tradicionale të saj, ndonëse është lënduar shumë nga fryma e kohës.
- Politika pro-familjare duhet të ndërmerren. Dy fëmijë nuk prodhojnë rritje.
- Duhet ndërtuar politika arsimore vlerore, jo shkollim ultra-permisiv, as edukim masovik libertinist.

- Shteti duhet të hapë qendra për të rinj, për këshillim dhe edukim, platforma për ndihmë prindërve dhe për edukimin e fëmijëve.
- Institucionet dhe politikëbërësit duhet që zhvillojnë fushata afirmuese të familjes, kurse personat referencialë duhet që t'i shmangen publicitetit përmes skandaleve.
- Shëndeti i shoqërisë tonë varet prej edhe prej vetë familjeve, bashkësive fetare, medias dhe individëve të ndërgjegjshëm, prej aktivizmit të OJQ-ve në këtë drejtim etj.

Conclusions

All descriptive scientific data and quantitative findings speak of the fact that the family is globally in crisis, which is reflected in our Macedonian and Albanian context as well. The family of the globalization period goes to dissolution, there is no space at XXI century family for three generations. The process of secularization or the weakening of the influence of religion has contributed to the weakening of family ties.

From the traditional type of family, which was a warm human, social, ethical, moral and educational environment, the today's family is becoming an entity of social anarchy, a conflict arena with individualistic tendencies and economic independence of its members as spouses as well as other family members. (Fetahu, 2012) From the whole analysis we generate the following specific conclusions and recommendations:

- *Family problems are old, marked in every period of human history, but today in larger proportions.*
- *The dissipation of the family of our time, among other things, is a consequence of modernization and radical materialism.*
- *Modernism has led to independent premarital cohabitation (and sex), postponement of marriage, and boom in the number of people in the age.*
- *Mediatization of sexuality and soaps counter culture destroy the family.*
- *The Albanian family still has the potential for healthy survival, bearing in mind its traditional spirit, though it is highly hurt by the spirit of the time.*
- *Pro-family policy needs to be undertaken.*
- *Value based education policies are needed, not ultra-permissive education approach and curricula.*

- *The state should open youth centers, counseling and education, parenting and childcare platforms.*
- *Institutions and policymakers should develop affirmative family campaigns, while influential people should avoid publicity through scandals.*
- *The health of our society is also dependent on families, religious communities, media and conscientious individuals, NGO activism in this regard.*

7. Bibliografia

- Aydın, M. (1997). *Kurumlar Sosyolojisi*, Ankara: Vadi Yayınları.
- Baben, A. *Dhuna ndaj grave në familje në Shqipëri*. UNICEF.
- Bakui, B. (2016). “Familja shqiptare në rrezik”, *Balkanweb*, 09.02.2016.
- Blackwell, A. (2017). “Families in XXI century”, *selfgrowth.com*, vizituar më 19.11.2017.
- Bobić, M. (2003). “Prekomponovanje braka, partnerstva i porodice u savremenim društvima”, *Stanovništvo*, vëll. 41, nr. 1-4, f. 65-91.
- Bullaç, A. (2005). *Koncepte dhe sisteme bashkëkohore*. Shkup: Logos-A.
- Conway, J. F. (2003). *The Canadian Family in Crisis*. Toronto: James Lorimer & Company Ltd., Publishers.
- Deutsche Welle*, 7.12.2007.
- Dushi, M. (2011). *Norma e fertilitetit në Kosovë: Perspektiva gjinore*. Prishtinë: UNFPA.
- European Association for Population Studies*, 2017.
- Gjergji, D.L. (2015). “Familja shqiptare dikur dhe sot”, në *Drita*, 16.02.2015.
- Fetahu, A. (2012). “Kriza e familjes tradicionale”. *Telegrafi*, 08.04.2017.
- Jashari, H. (2006). *Familja dhe bashkësia*. Tetovë: Çabej & UEJL
- Katavić, I. (2014). “Kriza, socijalna nesigurност i migracija uzrok pada nataliteta u BiH”, *Radio Slobodna Evropa*, 14.08.2014.
- Костовска, Л. (2017). *Македонија во бројки*, Скопје: Макстат, Државен завод за статистика.
- “Kriza savremene porodice: Svaki treći par se razvede”, *RTV Kontakt*, 18.11.2013.

- Kullashi, M. (2003). *Përplasja e identiteteve*. Pejë: Dukagjini.
- Lesthaege, R. (2014). "The second demographic transition: A concise overview of its development". *PNAS*, vëll. 111, nr. 51
- Pajaziti, A. (2009). *Fjalor i sociologjisë*. Logos-A & UEJL.
- Pajaziti, A. (2016a). "Kohë për bebe dhe spec heronj", në <http://tesheshi.com/nga-ali-pajaziti-kohe-per-bebe-dhe-spec-heronj/>, 18.11.2017.
- Pajaziti, A. (2016b), intervistë për Portalb.mk, 27.03.2016
- Republika*, 12.06.2015.
- Ribić, Dž. (2015). „Uloga porodice i obrazovanja u očuvanju vjerskog i kulturnog identiteta Bošnjaka“, IZ u BiH.
- Rosandić, H. (2017). "Razvod kao kriza porodice". *RTS, Dnevnik*, 18.12.2014, në <https://www.youtube.com/watch?v=GSH9YqzCgXw>
- Telegraf*, 11.08. 2017.
- Топузовска Латковиќ, М. et. al. (2013). *Студија за младите во Република Македонија*. Скопје: Friedrich Ebert Stiftung & ИСПИИ.
- Вечер*, 24.01.2014.
- Vesić, V. (2013). "Najgora kriza obitelji događa se u selima, ne u gradovima", *Večerni List*, 12.08.2013.
- Weller, Ch. (2017). "This is death to the family': Japan's fertility crisis is creating economic and social woes never seen before", *Business Insider*, 21.05.2017.
- Zanden J. W. V. (1990). *The Social Experience: An Introduction to Sociology*. New York-Toronto: McGraw-Hill Publishing Company.
- <https://www.sns.se/en/archive/families-in-the-21st-century/>, 21.11.2017.
- m.pixel.mk/zivot/semestvo/kade-e-nagjolemiot-zort-za-razvodi, 19.11.2017.
- <http://dialogplus.ch/familja-kosovare-mes-modernes-dhe-tradicionales-77911>
- <https://telegafi.com/kriza-e-familjes-tradicionale/21.11.2017>.
- [http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/File:Crude_marriage_rate,_selected_years,_1960-2015_\(per_1_000_persons\).png](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/File:Crude_marriage_rate,_selected_years,_1960-2015_(per_1_000_persons).png), 20.11.2017.
- <http://portalb.mk/386867-shtepite-e-pleqve-shume-pak-i-hasim-ne-komunat-shqiptare/11.07.2017>.